

Procedura për zgjedhjen e rektorit të UT-së



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО
UNIVERSITY OF TETOVO

Në bazë të neneve 100-107 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Komisioni Universitar i Zgjedhjeve për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës, miratoi këtë:

UDHËZUES

për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës, për mandatin 2023-2026

I. Procedura për zgjedhjen e rektorit

- (1) Procedurën për zgjedhjen e rektorit e inicon Senati i Universitetit, me propozim të Këshillit të Rektoratit.
- (2) Procedurën për zgjedhjen e rektorit e realizon Komisioni Universitar i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KUZ), i cili miraton udhëzues për tërë procedurën për zgjedhjen e rektorit.
- (3) Në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit, shpallet Konkurs publik për zgjedhjen e rektorit.
- (4) Konkursin për zgjedhjen e rektorit e shpall publikisht Senati i Universitetit.
- (5) Kandidatët për zgjedhjen e rektorit, në afatin e caktuar në konkursin publik, dorëzojnë kërkesë në komisionin universitar të zgjedhjeve, e cila duhet të përmbajë:
 - programin e punës për një periudhë trevjeçare;
 - të dhënat biografike dhe kompetencat e përcaktuara nga kriteret e përzgjedhjes.
- (6) Rektori zgjidhet nga radhët e profesorëve të rregullt në zgjedhje të lira, të drejtpërdrejta dhe të fshehta nga anëtarët e këshillave mësimorë-shkencorë.
- (7) Procedura për zgjedhjen e rektorit duhet të përfundojë në pajtim me kalendarin të cilin e sjell KUZ.

II. Kriteret e zgjedhjes së rektorit

II.1. Kriteret e detyrueshme për zgjedhjen e rektorit janë:

- 1) Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- 2) Të jetë nga radhët e profesorëve të rregullt (ordinar)
- 3) Kompetenca për kryerjen e funksionit rektor, edhe atë:
 - menaxhimi i proceseve në arsimin e lartë

Procedura për zgjedhjen e rektorit të UT-së

- zhvillimi i një universiteti autonom, modern dhe efikas, i cili garanton lirinë intelektuale të kuadrit mësimor, si dhe natyrën krijuese të procesit kërkimor, mësimor-arsimor dhe edukativ, bazuar në përvojat, traditën e universiteteve në RMV; si dhe standardet evropiane për arsim të lartë cilësor.
- për një universitet të reformuar dhe modern sipas standardeve të vendosura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në rajon si dhe sipas standardeve universitare evropiane.
- angazhimet për afirmimin e shkencës, kulturës, krijimtarisë letrare dhe artistike në RMV dhe më gjerë në rajon.
- aspekti strategjik dhe zhvillimor i Universitetit dhe arsimit të lartë në përgjithësi.
- për zhvillimin e parimeve demokratike, të vlerave të jetës njerëzore dhe produktive- shoqërore, të mirëqenies ekonomike, të përparimit të individit dhe të komunitetit akademik në tërësi.

II.2. Kriteret janë pjesë përbërëse e konkursit publik.

III. Puna e Komisionit Universitar të Zgjedhjeve

- (1) KUZ-në e formon Senati i Universitetit. Komisioni është i përbërë nga shtatë senatorë të zgjedhur me votim publik.
- (2) KUZ-ja i realizon këto detyra:
 - 1) Sjell udhëzime me të cilat përcaktohet: puna e tij dhe puna e komisioneve zgjedhore të njësisive, mënyra e votimit dhe numërimi i votave, rezultati i votimit, mënyra, afati dhe të ngjashme për komunikimin dhe dorëzimin e dokumenteve, akteve, njoftimeve, procesverbaleve etj., ruajtja dhe qasja në dokumentacionin zgjedhor, dhe për çështje të tjera lidhur me procedurën për zbatimin e votimit dhe konfirmimin e rezultateve nga votimi;
 - 2) KUZ-ja nga radhët e saj zgjedh kryetar dhe zëvendëskryetar. Zgjedhja e kryetarit bëhet në seancën konstituive. Deri në zgjedhjen e kryetarit seancën e drejton anëtari më i vjetër;
 - 3) Përcakton afate në të cilat duhet të formohen komisionet zgjedhore të njësisive;
 - 4) Emëron anëtarë të komisioneve zgjedhore nëse njësisia nuk formon komision zgjedhor në afatin e paraparë;
 - 5) Jep instruksione të domosdoshme për komisionet votuese, me kërkesë të tyre dhe sipas vlerësimit të vet;
 - 6) Përcakton kornizë kohore për zbatimin e aktiviteteve të nevojshme për zgjedhjen e rektorit;
 - 7) E përcakton ditën e votimit;
 - 8) E vlerëson plotësimin e kushteve për zgjedhjen e rektorit dhe saktësinë e kërkesës.
 - 9) E përcakton listën përfundimtare të kandidatëve për zgjedhjen e rektorit;
 - 10) E përcakton formën e fletëvotimeve dhe të procesverbalit për rezultatet e votimit për zgjedhjen e rektorit, për njësitë e Universitetit;

Procedura për zgjedhjen e rektorit të UT-së

- 11) E përcakton formën e procesverbalit për rezultatet nga votimi në njësitë e Universitetit dhe për rezultatin përfundimtar;
 - 12) Vendos për ankesa në pajtim me Statutin e Universitetit
 - 13) Në bazë të rezultateve të votimit, e shpall kandidatin e zgjedhur për rektor
 - 14) I mbledh rezultatet e votimit për zgjedhje të rektorit dhe e shpall publikisht vendimin për kandidatin e zgjedhur
- (3) Secili kandidat për rektor mund të përcaktojë mbikëqyrës të punës së KUZ-së.
 - (4) Të gjitha veprimet administrative dhe teknike kryhen përmes shërbimit qendror profesional dhe administrativ të Rektoratit.

III.1. Mbledhjet/seancat e KUZ-së

- 1) Seancat thirren dhe kryesohen nga kryetari i KUZ-së.
- 2) Kryetari është i detyruar të caktojë mbledhje të KUZ-së sa herë që është e paraparë në orarin e aktiviteteve për zgjedhjen e rektorit (shih shtojcën), si dhe kur është e nevojshme.
- 3) KUZ nga anëtarët e tij cakton mbajtës të procesverbalit.
- 4) Për vendimmarrje të plotë kërkohet prania e të paktën 4 (katër) anëtarëve të KUZ-së.
- 5) KUZ merr vendime me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të tij.
- 6) Seancat mund të thirren në mënyrë elektronike dhe/ose me telefon.
- 7) Për punën e KUZ-së mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari i KUZ-së dhe mbajtësi i procesverbalit. Procesverbali miratohet në seancën e parë pasuese.
- 8) Sekretari i përgjithshëm merr pjesë në seancat e KUZ-së (pa të drejtë vendimmarrjeje).
- 9) KUZ ka kuti postare elektronike. Inbox-i elektronik përdoret nga të gjithë anëtarët e KUZ-së.
- 10) Mbledhjet e KUZ-së mbahen në ambientet e Rektoratit.

IV. Puna e komisioneve zgjedhore të njësive

- (1) Komisionet zgjedhore të njësive (në tekstin e mëtejshëm KZNJ) i formojnë këshillat mësimorë-shkencorë, dhe përbëhen prej 5 (pesë) anëtarësh nga anëtarët e këshillave mësimorë-shkencorë, gjegjësisht të këshillave shkencorë.
- (2) Anëtarët e KZNJ-ve zgjidhen me votim të hapur, përveç në rastin kur këshillat mësimorë-shkencorë, vendosin që të zgjidhen me votim të fshehtë, në pajtim me ligjin.
- (3) Komisionet zgjedhore të njësive e realizojnë votimin për zgjedhje të rektorit në bazë të Ligjit për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit.
- (4) Dispozita më të përafërta për punën e komisioneve zgjedhore të njësive përcaktohen me aktin për formimin e tyre.

Procedura për zgjedhjen e rektorit të UT-së

IV.1. Mbledhjet e KZNJ-së

- (1) KZNJ punon në seanca/mbledhje.
- (2) KZNJ zgjedh kryetar nga radhët e anëtarëve të tij. Atë e zëvendëson një person i përcaktuar nga KZNJ.
- (3) Seancat thirren dhe drejtohen nga kryetari i KZNJ-së.
- (4) Kryetari është i detyruar të caktojë një seancë të KZNJ-së, sa herë që është e paraparë me orarin e aktiviteteve për zgjedhjen e rektorit (shih shtojcën), si dhe kur është e nevojshme.
- (5) Në seancat e KZNJ-së merr pjesë edhe sekretari i njësisë (pa të drejtë vendimmarrjeje).
- (6) Për vendimmarrje të plotë kërkohet prania e të paktën 3 (tre) anëtarëve të KZNJ-së.
- (7) KZNJ merr vendime me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të tij.
- (8) Seancat mund të thirren në mënyrë elektronike dhe/ose me telefon.
- (9) Për punën e KZNJ-së mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari i KZNJ-së dhe mbajtësi i procesverbalit. Procesverbalin e mban (e shkruan) sekretari. Procesverbali miratohet në seancën e parë të radhës.
- (10) Seancat e KZNJ-së mbahen në ambientet e njësisë.

V. Dorëzimi i kërkesave (dokumenteve për aplikim) për zgjedhjen e rektorit

- (1) Kërkesat (aplikimet) për zgjedhje të rektorit, kandidatët ia dorëzojnë KUZ-së në afatin e paraparë në konkursin publik.
- (2) Komisioni zgjedhor i universitetit e konfirmon listën e kandidatëve të cilët kanë dorëzuar dokumentacion të plotë të përcaktuar në konkursin publik.
- (3) Për ata kandidatë që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të plotë në pajtim me konkursin publik për zgjedhjen e rektorit, KUZ sjell vendim për refuzim (mospranim) dhe i njëjti u dorëzohet kandidatëve të refuzuar.
- (4) Kandidatët e refuzuar kanë të drejtë ankese deri te KUZ në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e marrjes së vendimit nga paragrafi i mëparshëm.
- (5) Komisioni zgjedhor i universitetit vendos për ankesat nga paragrafi i mëparshëm në afat prej 3 (tre) ditësh.
- (6) Vendimi i KUZ-së pas ankesave është përfundimtar. Vendimi nga ky paragraf i dorëzohet kandidatit i cili e ka parashtruar ankesën.
- (7) Komisioni zgjedhor i universitetit e përcakton listën përfundimtare të kandidatëve për zgjedhje të rektorit.

Procedura për zgjedhjen e rektorit të UT-së

VI. Materiali zgjedhor

- (1) Materialin zgjedhor e përbëjnë: lista zgjedhore e kandidatëve, lista zgjedhore, fletëvotimet, procesverbalet, raportet dhe shënimi për vendvotimin.
- (2) Këshilli mësimit-shkencor (në tekstin e mëtejshëm: KMSH) dhe KZNJ i dorëzojnë KUZ-së të dhëna për anëtarët e KMSH, të radhitur sipas titullit. Anëtarët e KMSH e përfaqësojnë listën zgjedhore (shih shtojcën). Lista zgjedhore e njësisë nënshkruhet nga kryetari i KZNJ-së dhe dekan i KMSH dhe dorëzohet në KUZ.
- (3) Lista e përcaktuar zgjedhore përfundimtare e anëtarëve të KMSH nënshkruhet edhe nga kryetari i KUZ-së, me ç'rast KUZ-ja e dorëzon atë në KZNJ e Universitetit së bashku me materialin zgjedhor dhe një kopje mbetet në KUZ.
- (4) KUZ e miraton listën përfundimtare të kandidatëve për zgjedhjen e rektorit dhe ia dorëzon KZNJ-së sipas rendit alfabetik.
- (5) KUZ e përcakton përmbajtjen dhe pamjen e fletëve të votimit.
- (6) Numri i fletëvotimeve për çdo njësi përcaktohet në bazë të numrit të anëtarëve të këshillave mësimit-shkencorë të përcaktuar me akt të dekanit, gjegjësisht drejtorit të njësisë.
- (7) Fletëvotimet vulosen dhe janë të njëjta për të gjitha njësitë e Universitetit. KUZ ua dorëzon fletëvotimet KZNJ-ve me procesverbal.
- (8) Dorëzimi i materialeve zgjedhore bëhet në atë mënyrë që KZNJ me procesverbal i mbledh materialet zgjedhore nga KUZ.
- (9) Dorëzimi i materialit zgjedhor bëhet në këtë mënyrë: KZNJ e merr me procesverbal materialin zgjedhor nga KUZ në pajtim me Kalendarin.

VII. Vëzhguesit e autorizuar

- (1) Në rast se kandidati për rektor autorizon një vëzhgues, ai i dorëzon KUZ-së një njoftim me shkrim për vëzhguesit e tij në KUZ dhe në KZNJ të çdo njësie. KUZ-ja ia përcjell njoftimin KZNJ-së. Vëzhguesi e konfirmon rolin e tij me vërtetimin e vëzhguesit të autorizuar (shih shtojcën) dhe identifikohet me një dokument identifikimi personal.
- (2) Vëzhguesit kanë të drejtë të kontrollojnë materialin zgjedhor dhe dokumentacionin tjetër lidhur me procesin zgjedhor, si dhe të marrin pjesë në votim, gjatë numërimit të votave dhe përcaktimit të rezultateve të votimit dhe dorëzimit të materialit zgjedhor.

VIII. Mënyra e votimit

- (1) Votimi për rektor realizohet në ditën e njëjtë të përcaktuar nga komisioni zgjedhor i

Procedura për zgjedhjen e rektorit të UT-së

- universitetit në periudhën nga ora 12 deri në ora 14 në të gjitha njësitë e Universitetit.
- (2) Votimi i këshillave mësimore-shkencorë, gjegjësisht këshillave shkencorë të njësive është i fshehtë.
 - (3) Votimi realizohet në hapësirën (sallën) e njësisë që është caktuar për atë qëllim dhe është e shënuar në mënyrë të dukshme. Në hyrje të sallës duhet të kenë një njoftim se në të po realizohet procesi i votimit.
 - (4) Nëse masat për menaxhimin e situatës epidemiologjike, të shkaktuar nga pandemia COVID-19, nuk kanë përfunduar gjatë periudhës së zgjedhjes së rektorit, KZNJ-ja është e detyruar ta rregullojë hapësirën e votimit në sallë, duke siguruar që distanca ndërmjet anëtarëve të KZNJ-së dhe zgjedhësve të jetë jo më pak se 2 metra. Anëtarët e KZNJ-së duhet të ulen në të njëjtin rresht, ndërsa kutia e votimit duhet të vendoset përballë tyre në një distancë prej të paktën 2 metrash në një lartësi prej rreth 80 cm. Pas kutisë së votimit, në një distancë prej të paktën 2 metrash nga ajo vendoset një paravan, i cili mundëson fshehtësinë e votimit. Në të majtë ose në të djathtë të kutisë së votimit duhet të sigurohet një vend për vëzhguesit e autorizuar, të përcaktuar nga kandidatët për rektor. Distanca ndërmjet të pranishmëve duhet të jetë gjithashtu në përputhje me masat e organeve kompetente në lidhje me situatën me COVID-19. KZNJ-ja do të kontrollojë këto kushte dhe do të përpilojë procesverbal për gjendjen e përcaktuar të hapësirës së votimit, materialin zgjedhor dhe kutinë e votimit.
 - (5) Në situatën e gjendjes nga paragrafi paraprak, gjatë votimit, në sallë, përveç anëtarëve të KZNJ-së dhe vëzhguesve të autorizuar, mund të votojnë më së shumti dy anëtarë të KMSH (njëri voton, tjetri përgatitet për votim).
 - (6) Gjatë votimit, anëtari i KMSH fillimisht nënshkruan në listën e zgjedhësve (shih shtojcën) dhe më pas e merr fletën e votimit. Anëtari i KMSH e plotëson atë pas paravanit, e vendos në kutinë e votimit dhe duhet të largohet menjëherë nga hapësira e votimit.
 - (7) Një anëtar i këshillit mësimore-shkencor, përkatësisht këshillit shkencor të njësisë mund të votojë vetëm për një kandidat për zgjedhjen e rektorit.
 - (8) Fletëvotim i vlefshëm konsiderohet ai në të cilin është rrethuar në mënyrë të rregullt një kandidat për zgjedhjen e rektorit.
 - (9) Pas përfundimit të votimit, KZNJ-ja e mbyll qendrën e votimit dhe fillon numërimin e votave, vetëm në prani të vëzhguesve të autorizuar. Së pari, përcaktohet se sa persona janë të regjistruar në listën zgjedhore, sa kanë votuar dhe sa fletë votimi kanë mbetur të papërdorura. Më pas bëhet rishikimi i fletëvotimeve të përdorura dhe, nëse ekzistojnë, ndahen fletëvotimet e pavlefshme nga fletëvotimet e vlefshme dhe përcaktohet numri i tyre.
 - (10) Më pas, nga fletëvotimet e vlefshme përcaktohet numri i votave të secilit prej kandidatëve.

IX. Përcaktimi i rezultateve të votimit

Procedura për zgjedhjen e rektorit të UT-së

(1) Komisioni zgjedhor i njësisë procedon me përcaktimin e rezultateve të votimit, me ç'rast numri i votave të fituara nga secili kandidat i çdo njësie shprehet veçmas në përqindje nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të njësisë dhe shumëzohet me numrin e senatorëve të zgjedhur nga njësia, duke marrë kështu numrin e pikëve të fituara nga secili prej kandidatëve.

(2) Llogaritja bëhet sipas formulës së mëposhtme:

[Numri i votave të fituara për çdo kandidat në njësi/numri i fletëvotimeve të vlefshme në njësi x 100]% x [numri i senatorëve nga njësia] = numri i pikëve të fituara nga kandidati

Shembull:

$$[10/25 \times 100]\% \times 2 = 80$$

Rezultati, i shprehur në pikët e fituara nga kandidatët, rrumbullakohet në tre shifra dhjetore, kështu që nëse shifra e parë e numrave të hequr është 0, 1, 2, 3 ose 4, atëherë shifra para saj nuk ndryshohet, ndërsa nëse shifra e parë e numrave të hequr është 5, 6, 7, 8 ose 9, atëherë shifra para saj rritet për 1.

Shembull:

80.52449236 rrumbullakohet në: 80.524

80.52459236 rrumbullakohet në: 80.525

- (3) Pasqyra e numrit të senatorëve sipas njësisë është pjesë e formularëve të udhëzuesit.
- (4) Pas përcaktimit të rezultateve të votimit, KZNJ përpilon procesverbal nga realizimi i votimit dhe plotëson raport.
- (5) Rrezultatet e votimit (procesverbalin, raportin dhe nëse ka material tjetër zgjedhor) KZNJ-ja ia dorëzon KUZ-së brenda dy orëve nga përfundimi i votimit.
- (6) Dorëzimi i rezultateve nga paragrafi paraprak i këtij neni bëhet me procesverbal.
- (7) KUZ-ja i mbledh rezultatet e votimit të të gjitha njësisë të Universitetit, ndërkaq kandidati që ka marrë numrin më të madh të pikëve në nivel universitar, pra shuma e pikëve të të cilit është më e larta pas mbledhjes së pikëve të marra për secilin kandidat në çdo njësi veç e veç, zgjidhet rektor.
- (8) Pas rezultateve të marra nga KUZ, kryetari i Senatit e shpall kandidatin që ka marrë numrin më të madh të pikëve në nivel universitar, gjegjësisht shuma e pikëve të të cilit është më e larta pas mbledhjes së pikëve të kandidatit në secilën njësi në veçanti.

X. Menaxhimi i dokumentacionit zgjedhor

- (1) Dokumentacioni zgjedhor dhe dokumentacioni tjetër në kompetencë të KUZ-së dhe KZNJ-së duhet të nënshkruhen në mënyrë adekuate nga kryetarët ose

Procedura për zgjedhjen e rektorit të UT-së

zëvendësit e tyre apo personat e autorizuar nga KUZ dhe KZNJ, në përputhje me formularët e bashkëngjitur me këtë udhëzues.

- (2) Dokumentacionin zgjedhor lidhur me procedurën për zgjedhjen e rektorit e mban shërbimi profesional dhe administrativ i Rektoratit.
- (3) Deri në përfundimin e procedurës për zgjedhjen e rektorit, kandidatët për rektor kanë qasje në dokumentacionin zgjedhor.
- (4) Për të siguruar realizimin e pandërprerë dhe praktik votimit, KUZ-ja do të përgatisë formularë të unifikuar që do të jenë të vlefshëm për të gjitha njësitë (fletë votimi, procesverbale, raporte, shenja të qendrave të votimit dhe të tjera, nëse është e nevojshme).

XI. Komunikimi, dokumentacioni i zgjedhjeve, nënshkrimi dhe mbajtja e tij

- (1) Komunikimi ndërmjet anëtarëve të KUZ-së dhe KZNJ-së bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet kutive postare/adresave elektronike të KUZ-së dhe KZNJ-së. KZNJ-të i dorëzojnë adresat elektronike në KUZ. KUZ-ja e publikon adresën e saj elektronike në faqen e internetit të Universitetit. Komunikimi mund të bëhet edhe me telefon. Të dyja mënyrat konsiderohen komunikim i duhur.
- (2) Dorëzimi i dokumentacionit dhe të tjerat (nëse është i nevojshëm), përveç materialit zgjedhor, ndërmjet KUZ-së dhe KZNJ-së zhvillohet në mënyrë elektronike.
- (3) Komunikimi ndërmjet anëtarëve të KUZ-së dhe kandidatëve për rektor bëhet në mënyrë elektronike në kutitë elektronike të kandidatëve, të dorëzuara në aplikimin për rektor dhe në kutinë elektronike të KUZ/KZNJ dhe me telefon. Të dyja mënyrat konsiderohen komunikim i duhur.
- (4) Dorëzimi i parashtrësve, akteve dhe dokumentacionit tjetër ndërmjet KUZ-së dhe kandidatëve për rektor bëhet në mënyrë elektronike, në bazë të pëlqimit të kandidatit/kandidatëve. Dokumentacioni duhet të nënshkruhet dhe skanohet ose të nënshkruhet me nënshkrim elektronik nga një person/persona të autorizuar. KUZ-ja dhe kandidatët për rektor njoftohen me telefon se dokumenti përkatës u është dërguar me e-mail.
- (5) Pranimi, dorëzimi etj. i dokumentacionit zgjedhor (procesverbal, raport, fletë votimi etj.) kryhet drejtpërdrejt nga KUZ në KZNJ dhe anasjelltas, në Rektoratin e UT-së.
- (6) Gjatë dorëzimit të dokumenteve në mënyrë elektronike, si moment i dorëzimit/pranimit të dokumentit llogaritet çasti kur është dërguar njoftimi me shkrim.

Procedura për zgjedhjen e rektorit të UT-së

- (7) Dokumentacioni i zgjedhjeve dhe dokumentet tjera të prodhuara dhe të komunikuar gjatë procedurës zgjedhore nga KUZ dhe KZNI nënshkruhen nga kryetarët ose zëvendësit e tyre apo anëtarët që i kanë autorizuar.
- (8) Dokumentacioni zgjedhor që do të dalë nga e gjithë procedura zgjedhore arkivohet dhe ruhet në shërbimin profesional-administrativ të Universitetit.

XII. Kandidatët që nuk janë zgjedhur

- (1) Komisioni zgjedhor i Universitetit ua dorëzon vendimin kandidatëve që nuk janë zgjedhur në afat prej 3 (tre) ditësh, duke e llogaritur nga dita e votimit.
- (2) Kandidatët për rektor të cilët nuk janë zgjedhur, nëse mendojnë se gjatë realizimit të procedurës dhe votimit janë bërë shkelje nga ana e KZNI-së dhe KUZ-së kanë të drejtë të parashtrijnë kundërshtim (ankesë) në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
- (3) Komisioni zgjedhor i universitetit vendos pas kundërshtimit (ankesës) nga paragrafi i kaluar në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e marrjes së ankesës.
- (4) Nëse KUZ-ja e pranon kundërshtimin (ankesën) e kandidatit që nuk është zgjedhur, për rezultatet e shpallura nga njësia e Universitetit, votimi në atë njësi përsëritet, nëse rezultati i zgjedhjeve në atë njësi mund të ndikojë në rezultatin përfundimtar.
- (5) Vendimi i KUZ-së është përfundimtar.
- (6) Kundër vendimit nga paragrafi 5 i këtij neni mund të prashtrohet padi në gjykatën administrative.

Kryetari i KUZ-së

Prof. Dr. Nderim Zeqiri

